

AKT THEMELIMI

i

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“HENRY’S LOUNGE 2” Sh.P.K.

TIRANË, 2021

Neni 1

Emri

- 1.1 Sot, më datë 11.08.2021 krijohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, emri i së cilës është "HENRY'S LOUNGE 2" Sh.P.K, në vijim e referuar shkurt si "Shoqëria"

Neni 2

Themelimi

- 2.1 Shoqëria themelohet bazuar në legjislacionin shqiptarë në fuqi dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar, me këtë Akt Themelimi dhe me Statutin e saj.

Neni 3

Selia

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr. "Ndre Mjeda", Godina 3, Hyrja 5, Apartamenti 51.
- 3.2 Shoqëria mund të hapë dhe mbajë zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të hapë ose mbyllë zyra në vende të ndryshme përveç selisë së Shoqërisë brenda territorit shqiptar.

Neni 4

Ortakët e Shoqërisë

- 4.1 Ortaku dhe themeluesi i Shoqërisë është:
 - a. **Z.Xhuljano Shehi**, zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkuara në shumën prej 100 (njëqind) Lekë, të cilat përfaqësojnë 100 % (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;

Neni 5

Kapitali Themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 100 (njëqind) Lekë, i ndarë në 1(një) kuotë, me vlerë sipas nenit 4 me sipër.
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute në para, plotësisht të nënshkuara dhe paguara dhe zotërohet nga ortaku i vetëm i shoqërisë sipas Nenit 4 të këtij Akti Themelimi.

- 5.3 Kuotat, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe pas ushtrimit të së drejtës së parablerjes ndaj ortakëve të tjerë të Shoqërisë sipas parashikimeve statutore sipas parashikimeve statutore, janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës së shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër dhe forme të parashikuar nga ligji dhe/ose statutit.

Neni 6 Objekti

- 6.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin si më poshtë vijon:
“Aktivitete te tregtimit te pijeve me pakice, sherbim bar kafe”
- 6.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 7 Kohëzgjatja

- 7.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 8 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me ligjet shqiptare, mund të marrë, por pa u kufizuar në, vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit/ëve kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit, etj., sikurse parashikohet në Statut dhe në legjisllacionin shqiptar në fuqi.

Neni 9 Administrimi i Shoqërisë

- 9.1 Administratori/ët i/e parë të Shoqërisë janë:
- **Z.Xhuljano Shehi**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 23.12.1992, i pajisur me leternjoftimin nr. 036147703 nr. Personal J21223052B me adresë në Rruga “Shaban Hoxha” Mullet Tiranë
- 9.2 Administratori/ët emërohen për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi. Administratorët emërohen dhe/ose shkarkohen nga detyra, në çdo kohë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë.

Neni 10
Ligji i Zbatueshëm

- 10.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 10.2 Çdo konflikt që mund të lindë mes ortakëve të Shoqërisë në lidhje me, ose si rrjedhojë e këtij akti themelimi do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nënshkruar në Tiranë, sot më 11.08.2021

ORTAKËT THEMELUES

Z.Xhuljano Shehi

XHULJANO SHEHI
